



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.05.2023

Nr: 93

Ora: 15:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 55, DATË 08.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA
KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar nga z. Franci Nuri

OBJEKT: 1. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 452, datë 06.05.2023 "Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars deri 2 maj 2023";

2. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 456, datë 06.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387 nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga koalicioni "Bashkë Fitojmë", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023";

3. Ndryshimin pjesërisht të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 452 datë 06.05.2023, duke vendosur:

a) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesat për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit Koalicioni "Bashkë Fitojmë" në bashkinë Tiranë, me vendndodhje: Rr. "Artan Lenja"; Rr. "Milto Tutulani"; Rr. "Margarita Tutulani", në bashkinë Elbasan me vendndodhje pranë Universitetit "Aleksandër Xhuvani";

b) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për mbylljen e zyrës së Partisë Demokratike në rrugën "Nasip Pallvo", pranë Liceut Artistik, për arsyen specifike sepse kjo zyrë nuk i takon subjektit zgjedhor "PD" të regjistruar në këto zgjedhje nga KQZ, por i takon entitetit politik që identifikohet me koalicionin Bashkë "Fitojmë" dhe për më tepër, kjo nuk është zyrë elektorale në kuptim të Kodit Zgjedhor, por është zyra e përhershme politike / selia e PD dega nr. 2 Tiranë;

c) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për heqjen e materialeve propagandistike, në bashkitë Durrës dhe Tiranë, në lidhje me subjektin Koalicioni "Bashkë Fitojmë", në shtylla ndriçimi, në rrugën "Veli Dedi" bashkia Tiranë;

4. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 456, datë 06.05.2023, duke vendosur: Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik mbi

fasadën e godinës së Postës Shqiptare në Kavajë, të subjektit Koalicioni "Bashkë Fitojmë".

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja "b" dhe 123/1, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Monitoruesit e fushatës zgjedhore të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në raportet për periudhën 7 mars deri në 2 maj 2023, kanë konstatuar se një ndër subjektet zgjedhore që ka kryer shkelje të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" është koalicioni "Bashkë Fitojmë". Gjithashtu, pranë KQZ-së është administruar denoncimi ndaj koalicionit "Bashkë Fitojmë" me nr. 387 ID, me kërkues "Partia Socialiste e Shqipërisë", dega Kavajë, e cila ka kërkuar heqjen e materialeve propagandistike të këtij koalicioni, të vendosura në kundërshtim me ligjin.
2. Në seancën publike të datës 06.05.2023, me vendimin nr. 452, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve urdhëroi mbylljen e menjëhershme të zyrave zgjedhore në bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Kukës në kundërshtim me ligjin të koalicionit "Bashkë Fitojmë". Po në këtë seancë publike, me anë të vendimit nr. 456, Komisioneri urdhëroi heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik mbi fasadën e Postës Shqiptare, Kavajë të koalicionit "Bashkë Fitojmë".

3. Kundër vendimit nr. 452, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka paraqitur kërkesë ankimore koalicioni "Bashkë Fitojmë", duke kërkuar ndryshimin pjesërisht të vendimit, si më poshtë:
- Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesat për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit Koalicioni "Bashkë Fitojmë" në bashkinë Tiranë, me vendndodhje: Rr. "Artan Lenja"; Rr. "Milto Tutulani"; Rr. "Margarita Tutulani", në bashkinë Elbasan me vendndodhje pranë Universitetit "Aleksandër Xhuvani";
 - Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për mbylljen e zyrës së Partisë Demokratike në rrugën "Nasip Pallvo", pranë Liceut Artistik, për arsye specifike sepse kjo zyrë nuk i takon subjektit zgjedhor "PD" të regjistruar në këto zgjedhje nga KQZ, por i takon entitetit politik që identifikohet me koalicionin Bashkë "Fitojmë" dhe për më tepër, kjo nuk është zyrë elektorale në kuptim të Kodit Zgjedhor, por është zyra e përhershme politike / selia e PD dega nr. 2 Tiranë;
 - Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për heqjen e materialeve propagandistike, në bashkitë Durrës dhe Tiranë, në lidhje me subjektin Koalicioni "Bashkë Fitojmë", në shtylla ndriçimi, në rrugën "Veli Dedi" bashkia Tiranë.
4. Kundër vendimit nr. 456, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka paraqitur kërkesë ankimore koalicioni "Bashkë Fitojmë", duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pushimin e hetimit administrativ në lidhje me heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare në Kavajë, të subjektit zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë".
5. Kërkesa ankimore nr. 55, datë 08.05.2023 iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Koli Bele. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 11.05.2023, ora 14:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, si dhe përfaqësuesi i palës ankimuese, koalicionit "Bashkë Fitojmë" z. Franci Nuri.

6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 55, datë 08.05.2023;
- Vendimin nr. 452, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars deri 2 maj 2023”;
- Vendimin nr. 456, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387 nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”;
- Kontrata e qirasë, pranë notere Anila Çelaj, nr. repertori 1856, datë 05.04.2023
- Udhëzimin nr. 06, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Me vendimin nr. 452, datë 06.05.2023 Komisioneri ka urdhëruar mbylljen e menjëhershme të zyrës zgjedhore të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, në adresën rr. “Nasip Pavllo”. Provat e shqyrtuara demonstrojnë se kjo zyrë nuk i përket subjektit zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, por i përket entitetit politik që identifikohet me koalicionin Bashkë "Fitojmë", i cili nuk merr pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. (shih vendimin e Komisionerit nr. 178, datë 18.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë” (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”). Në kontratën e qirasë lidhur pranë noteres Anila Çelaj, në nenin 4 të kësaj kontrate provohet se ambienti do të jetë në përdorim për zyrat e degës së Partisë Demokratike. Kjo do të thotë se shkronja “f” e pikës 1, të pjesës urdhëruese të vendimit të Komisionerit nr. 452, datë 06.05.2023 duhet të shfuqizohet për shkak se ndodhemi përpara të lajthimit në subjekt.

2. Lidhur me shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të pikës 1, të pjesës urdhëruese të vendimit nr. 452, datë 06.05.2023, ankuesi nuk arriti të provojë shkelje të dispozitave të udhëzimit nr. 06, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”. Për këtë arsye, KAS-i e gjen vendimin në këto pika të mbështetur në prova dhe në ligj.
3. Udhëzimi nr. 06, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” në pikën 2, të nenit 3 përcakton se *“Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit”*. Urdhërimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për heqjen e materialeve propagandistike të koalicionit “Bashkë Fitojmë” në shtyllat e ndriçimit është i bazuar në këtë pikë. Ankuesi nuk provoi përpara KAS-it se vendimi i Komisionerit vjen në kundërshtim me këtë udhëzim. Në këto rrethana edhe kjo kërkesë konsiderohet nga KAS-i si e pambështetur në prova dhe në ligj.
4. Lidhur me kërkesën për ndryshimin e vendimit nr. 456, datë 06.05.2023, KAS-i konstaton se Komisioneri ka vepruar drejt kur ka udhëruar heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare, Kavajë. Komisioneri nuk ka hetuar përgjegjësinë e titullarit të filialit të Postës Shqiptare Kavajë, për lejimin e subjektit zgjedhor që të përdorë asetin publik për afishimin e materialeve zgjedhore. KAS-i për këtë shkak nuk mund të thellohet në shqyrtimin e kësaj përgjegjësie.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore nr. 55, datë 08.05.2023 të depozituar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Shfuqizimin e shkronjës “f” të pikës 1 të pjesës urdhëruese të vendimit nr. 452, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij, sipas pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më datë 11.05.2023.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar